31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm**.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jete të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të**

pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	<p>Emri i Autoritetit Kontraktues: Komuna e Rahovecit me adresë në rrugën "Xhelal Hajda – Toni" të cilën e përfaqëson Menaxheri i Prokurimit: Jetulla Kabashi dhe</p> <p>Emri i Kontraktuesit: "PROing&Partners" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Kujtim Zena & N.T.SH. "Dino" Sh.p.k. me adresë në Lipjan, të cilën e përfaqëson Ramadan Salihu</p> <p>janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:</p> <p style="text-align: center;">TITULLI I KONTRATËS: NDËRTIMI I SHMFU "HERONJËT E KOSOVËS" NË HOQË E VOGËL – BRESTOC</p> <p style="text-align: center;">Numri i Prokurimit: 623-18-6337-5-1-1 Numri i Brendshëm: 623-18-050-5-1-1</p>
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	<p>10% i ndalet një vit pas pranimit teknik të punimeve.</p> <p>Pagesa e shumës së ndalur në emer të sigurimit të punimeve (10%) mund të i paguhet:</p> <p>Operatorit Ekonomik me :</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Vendim të Kryetarit të Komunës për leshimin e pageses së 10% të ndalur në emer të sigurimit të punimeve dhe b. Nese OE e sjell garancionin nga ndonjë kompani e licencuar e sigurimeve ose nga ndonjë bankë (për periudhën për të cilën edhe është ndalur 10%). <p>Pagesat kontraktuesit do t'i bëhet në bazë të raportit të organit mbikqyrës.</p>
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda [5] ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar është [5] ditë
Inspektimi dhe testimi	9.1	Organi Mbykqyrës është: Inspektimi dhe testimi bëhet konform kushteve të përgjithshme të kontratës.
Fillimi i punëve	10.1	Punët do të fillojnë brenda Pesë [5] dite pune pas ftesës nga autoriteti kontraktues përkatësisht nga ana e organit mbikëqyrës ose menaxheri i projektit. Ftesa për fillim të punëve do të bëhet me krijimin e kushteve atmosferike.
	10.2	Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonësive të lejuara nga organi mbykqyrës. Kontrata është: 24 muaj.

Përmirësimi i defekteve	13.1	Periodha garantuese e defekteve është: 12 muaj.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë: Sipas Kushteve të përgjithshme të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë/realizoj ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, punëdhënësi, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.
Parapagimi	20.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: N/A
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% të vlerës së kontratës = 46,429.88 €, për kohëzgjatjen e periudhës prej: [24 muaj + 30 ditë].
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve. Pagesa do të bëhet vetëm për punët e përfunduara sipas raportit të organit mbikëqyrës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	Autoriteti kontraktues cakton departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Gjakovë – Dega Rahovec] në pajtim me ligjin në Kosovë.

Paramasa dhe Paralogaria					
SHFMU "Heronjtë e Kosovës"					
P + 1					
Hoçë e Vogël - Brestoc, K.K. Rahovec					
1. ARKITEKTURA					
1.1. PUNËT PËRGADITORE					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totall
1.1.1	Inqizimi i parcelles ne vendin e parapare per ndertimin e shkolles , si dhe bartja e pikave nga projekti ne terren se bashku me organin mbikqyres	paush.	1.00	50.00 €	50.00
1.1.2	Demolimi i objektit ekzistues të çerdhës dhe portikut (objekt i vogël në hyrje). Materiali të transportohet në deponi, ku e parasheh Investitori	m ³	1485.00	2.00 €	2,970.00
1.1.3	Demolimi i parterit ekzistues dhe fushës së lojës, dhe të llohet hapësira për ndërtimin e objektit të ri. Materiali të transportohet në deponi, të caktuar nga Investitori.	m ²	1215.00	0.70 €	850.50
1.1.4	Furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohëshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriqimit të kantierit.	paush.	1.00	200.00 €	200.00
1.1.5	Punimi i rrethojës së kantierit. Rrethoja duhet punuar me material të qëndrueshëm të paktën llamarinë se zingtuar me lartësi 2 m. Vërejtje: Të krijohet edhe hapësira për kalim të nxënësëve dhe stafit të shkollës deri te objekti ekzistues i shkollës deri në përfundim të objektit të ri të shkollës.	m'	480.00	1.00 €	480.00
1.1.6	Punimi i objekteve përcjellëse për nevoja të kantierit. Këtu përfshihen hapësira zyrat e menaxhimit të kantierit, mbikëqyrësin si dhe hapësirat për punëtorë (garderobat dhe trapezaria)	paush.	1.00	400.00 €	400.00
1.1.7	Pas përfundimit të plotë të ndërtimit të objektit të ri të shkollës të bëhet demolimi i objektit ekzistues të shkollës dhe të llohet hapësira për ndërtimin e fushës së re të lojës. Materiali të transportohet në deponi të caktuar nga investitori.	m ²	3140.00	2.00 €	6,280.00
1.1.8	Pastrimi i parcelles nga mbeturinat e mundshme, materiall largohet ne deponi legale.	paush.	1.00	200.00 €	200.00
TOTALI POSICIONI:					11,430.50



1.2. PUNËT E DHEUT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.2.1	Germimi i gjere i dheut ne thellesi mesatare h= 40 cm per rrafshimin e terrenit, materiali i germuar largohet ne deponi legale	m ³	1270.00	1.00 €	1,270.00
1.2.2	Gërmimi i dheut të kategorisë së III -të për hapjen e themeleve shiritore dhe largimi i të njëjtit në largësi brenda kantierit për përdorim në rregullimin e oborrit, pjesa e teperet dhe e podobishme largohet ne deboni	m ³	842.00	0.50 €	421.00
1.2.3	Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e zhavorit 0-62 mm nën themelet-e objektit në trashësi d= 20.0 cm mbi dheun e ngjeshur me mekanizim përkatës	m ³	135.00	8.00 €	1,080.00
1.2.4	Furnizimi , hudhja dhe ngjeshja e gurit te thyer-perberje natyrore perreth coklles dhe nen pllaken-e dyshemes	m ²	450.00	7.00 €	3,150.00
1.2.5	Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e zhavorit 0-62 mm në trashësi d= 15.0 cm mbi perberjen natyrore e ngjeshur me mekanizim përkatës nen pllaken e themeleve	m ³	145.00	5.00 €	725.00
TOTALI POSICIONI:					6,646.00
1.3. PUNËT E BETONIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.3.1	Furnizimi dhe betonimi i shtresës së betonit me beton të ngjeshur C15 Mpa ne trashësi d = 4-6 cm nen themelet shiritore si shtrese mbrojtëse e armatures	m ³	28.00	10.00 €	280.00
1.3.2	Furnizimi dhe betonimi i themeleve shiritore, coklles dhe pllakes se dyshemes me beton te armuar C25- 30 Mpa në pahitë përkatëse sipas projektit. Siperfaqja e jashtme e pahive te jete e lemuar .	m ³	580.00	50.00 €	29,000.00
1.3.3	Latimi dhe betonimi i trajeve dhe pllakes konstruktive t=20.0 cm me beton te armuar C25/30 Mpa në per katin perdhës dhe katin e pare me pahitë përkatëse sipas projektit. Siperfaqja e pahive te jete e lemuar .	m ³	420.00	50.00 €	21,000.00
1.3.4	Latimi dhe betonimi i shtyllave me beton të armuar C25/30 në kallupet përkatëse sipas projektit.	m ³	45.00	50.00 €	2,250.00
1.3.5	Furnizimi dhe betonimi i elementeve tjera konstruktive si parahyrjet, hyrjet shkallet arkitrajt etj. Me beton C25/30 ne kallupet perkatëse sipas projektit.	m ³	48.00	50.00 €	2,400.00
1.3.6	Furnizimi i materialit dhe punimi i shtreses se estrihut ne pllaken e dyshemes dhe katit me makinë me trashësi 5-7cm mbi bazën e përgatitur të shtresave izoluese strioporit t=3cm dhe shtreses hidroizoluese.	m ²	1495.00	4.00 €	5,980.00
1.3.6	Furnizimi i materialit dhe punimi i shtreses mbrojtëse (estrih) me makinë me trashësi 4-5 cm mbi bazën e përgatitur të shtresave izoluese nen konstruksionin e kulmit	m ²	910.00	3.00 €	2,730.00
1.3.7	Latimi dhe betonimi i shtyllave dhe mureve te gardhit ta jashtem me beton të armuar C25/30	m ³	250.00	40.00 €	10,000.00
TOTALI POSICIONI:					73,640.00



1.4. PUNËT E ARMATURES					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.4.1	Blerja, transporti, prerja si dhe vendosja e ARMATURËS ÇBR-400/500 Mpa në tërësi në të gjitha pozicionet sipas llogarisë statike:cca	kg	96440.00	0.55 €	53,042.00
1.4.2	Furnizimi, transporti, prerja dhe vendosja e rrjetave Q-378 ne te dy zonat me specifikaclon Ø8.5x15x15 cm 5.94 kg/m2 me palim 40 cm	kg	118256.00	0.12 €	14,190.72
TOTALI POSICIONI:					67,232.72
1.5. PUNËT E MURATIMIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.5.1	Furnizimi dhe muratimi i mureve te jashtme dhe te mbrendshme me blloka te argjiles d=25cm; d=20 cm me llaq vazhdues ne perpjese 1:2:6 ne teresi sipas projektit .	m ³	434.00	30.00 €	13,020.00
1.5.2	Furnizimi dhe muratimi i mureve te mbrendshme me blloka te argjiles d=12cm , muri me llaq vazhdues ne perpjese 1:2:6 ne teresi sipas projektit.	m ²	120.00	20.00 €	2,400.00
1.5.3	Furnizimi dhe muratimi i mureve te atkes me blloka te argjiles d=15 cm , muri me llaq vazhdues ne perpjese 1:2:6 ne teresi sipas projektit, per llogari te merret shtangimet vertikale dhe horizontale me beton arme.	m ²	100.00	30.00 €	3,000.00
1.5.4	Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve të brendshme dhe plafonit me llaq gelqeror në përpjesë 1:3 në dy shtresa me finalizim të lëmuar.Ne pozicion të parashihet vendosja e kendoreve ne këndet e mureve.	m ²	5220.00	3.00 €	15,660.00
TOTALI POSICIONI:					34,080.00
1.6. PUNËT E KULMIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.6.1	Furnizimi, punimi dhe montimi i konstrukcionit të kulmit komplet mbi pllakë nga druri i përpunuar me: Mahite=10/12cm;/ Nenmahite=12x14cm;Shtyllat=12x14cm Shtangimet=12x12cm; danat=(15x7)x2cm,; në tërësi sipas projektit. Llogaria në m2	m ²	943.00	10.00 €	9,430.00
1.6.2	Furnizimi dhe vendosja e dërrasave t=24 mm mbi konstrukcionin kulmit, si bazament për vendosjen e letrës difuzive dhe listelave. Llogaria në m ²	m ²	943.00	3.00 €	2,829.00
1.6.3	Furnizimi dhe vendosja e kontra listelave 2/4 cm në çdo 70cm mbi dyshemenë e dërrasave per krijimin e siperfaqes ajruese . Llogaria në m2	m ²	943.00	0.50 €	471.50
1.6.4	Furnizimi dhe vendosja e listelave 5/8 në çdo 80 cm mbi kontralistela . Llogaria në m2	m ²	943.00	0.50 €	471.50
TOTALI POSICIONI:					13,202.00




1.7. PUNËT E LLAMARINËS					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.7.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i mbulesës së kulmit me llamarinë të plastifikuar dhe valëzuar d=0.55mm me brinjë t=4cm - "Tip T50" (100% e mbuleses), përfshi kulmaret, aksesoret perçjelles për kompletim, dhe me shtresën kundër kondenzit, ngjyrë sipas zgjedhjes së investitorit. Llogaria në m2 në sipërfaqe të rrafshhtë.	m ²	943.00	6.00 €	5,658.00
1.7.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i ullukëve horizontal nga llamarina e plastifikuar t=0.55mm.	m'	142.00	6.00 €	852.00
1.7.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i ullukëve vertikal nga llamarina e plastifikuar me dimenzione Ø12cm, t=0.55mm	m'	90.00	5.00 €	450.00
1.7.4	Furnizimi dhe montimi i llamarinës së plastifikuar me ngjyrë sipas investitorit për punimin e mveshjeve të oxhakut	cope	1.00	25.00 €	25.00
1.7.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i mveshjes horizontale dhe vertikale e mureve të atikes nga llamarina e plastifikuar t=0.55mm. Me gjeresi zhvilluese mesatare deri 1.20 m. Lidhja duhet të bëhet në mënyrë shumë profesionale	m'	142.00	8.00 €	1,136.00
TOTALI POSICIONI:					8,121.00

1.8. PUNËT E HIDROIZOLIMIT DHE TERMOLIZOLIMIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.8.1	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit horizontal me saldim të lidhjeve në pllaken e dyshemes, hidroizolimi punohet me material hidroizolues shumështrësor - tipi kondor, t=4mm dhe me një shtresë lysterje bituliti. Llogaria në m2 në llogaritje të merren paraprkishtë izolimi edhe para vendosjes së muratues	m ²	780.00	2.00 €	1,560.00
1.8.2	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit horizontal në dysheme dhe vertikal në lartësi h=30cm me saldim të lidhjeve në muret e këthave sanitare, me material hidroizolues shumështrësor - tipi kondor, me dy shtresa t=3mm dhe në mes të shtresave lysterje me bituliti.	m ²	145.00	3.00 €	435.00
1.8.3	Furnizimi dhe punimi me stropit N4 i fasadës së jashtme me trashësi t=20 cm sipas projektit. Në çmim të llogaritjet ngjitesit dhe elementet lidhëse-tipllat	m ²	880.00	6.00 €	5,280.00
1.8.4	Furnizimi dhe shtrirja e letres difuzive 110gr/m ² mbi sipërfaqen paraprakisht të mveshur me dërrasa të konstrukcionit të kulmit, përfshirë të gjitha punet përgatitore .Llogaria për m ² bazës së kulmit	m ²	943.00	0.30 €	282.90
1.8.5	Furnizimi dhe vendosja e materialit termoizolues me trashësi t=8.0 cm e cila vendoset mbi pllaken e kulmit, sipas projektit. Në çmim të llogaritjet edhe shtresa mbrojtëse e termoizolimit folja plastike.	m ²	910.00	3.00 €	2,730.00
TOTALI POSICIONI:					10,287.90




1.9. PUNËT E ZDRUKTHËTARISË					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.9.1	Furnizimi dhe montimi i sipërfaqes ndriqes, fasade gjysym strukturale me profila te aluminit dhe Xhami i lameluar 3.1.3 x14 (mbushje gaz argon) x 6 me PARSOL me ngjyre te zezë. Llogaria në m ² . Dimensionet e profilit horizontal dhe vertikal te ju pershtaten sipërfaqes dhe detajeve te projektit. 5=6.80*8.1 m	m ²	65.00	75.00 €	4,875.00
1.9.2	Furnizimi prodhimi dhe montimi i hapjes në fasade. Trashesia e ramit 8 cm dhe krahut 6 cm . Prodhuesi i sistemit Alumil , Schuko ose prodhues me specifika te ngjashme. Xhami i lameluar 3.1.3 mm x 14 mm (mbushje gaz argon) x 6 mm PARCOL me ngjyre te zeze. Sistemi duhet te mbeshtet me certifikata dhe ateste adekuate per secilin pozicion. Pos.Dr7 120x90 cm	copë	1.00	250.00 €	250.00
1.9.3	Furnizimi prodhimi dhe montimi i hapjes në fasade. Trashesia e ramit 8 cm dhe krahut 6 cm . Prodhuesi i sistemit Alumil , Schuko ose prodhues me specifika te ngjashme. Xhami i lameluar 3.1.3 mm x 14 mm (mbushje gaz argon) x 6 mm PARCOL me ngjyre te zeze. Sistemi duhet te mbeshtet me certifikata dhe ateste adekuate per secilin pozicion. Pos D1: 265x220 cm.	copë	1.00	550.00 €	550.00
	Furnizimi dhe montimi i dritareve prej materialit të plastikës me trashesi te profilit t=8.0cm me min. 5 komora (hapësira termike) dhe tre mbyllje gome. Plastika te jet e perforcuar me profil te çelikut (d=2mm) , adekuat per profillin e caktuar te PVC-se. Profili duhet te arrinë vlerat Uf prej 1.3 W/m2. Dritaret do të jenë me XHAM TE TREFISHT 4+16+4+16+4 mm, Uw=0,8 ë.m-2K-1 mbushje me argon, Ug=0,6 ë.m-2K-1, izolimi akustik Rë-34 dB. Mekanizmi për hapje jo më lartë se 175 cm. Të aplikohet sistem katërshtresor mbrojtës SIKKENS (apo të ngjajshme) me impregnim të thellë.				
1.9.4	Pos Dr1 me dimensione 160*300 cm	copë	22.00	380.00 €	8,360.00
1.9.5	Pos Dr2 me dimensione 150*160 cm	copë	14.00	250.00 €	3,500.00
1.9.6	Pos Dr3 me dimensione 180*220 cm	copë	2.00	300.00 €	600.00
1.9.7	Pos Dr4 me dimensione 160*220 cm	copë	2.00	300.00 €	600.00
1.9.8	Pos Dr5 me dimensione 90x90 cm	copë	12.00	180.00 €	2,160.00
1.9.9	Pos Dr6 me dimensione 90*254cm	copë	1.00	350.00 €	350.00
	Furnizimi dhe montimi i derës te erëmbrojtësit me mbi ndriqim prej profileve te aluminit profil t=8.0cm me xham të trefisht 4+16+4+16+4 mm, Uë=0,8 ë.m-2K-1 mbushje me argon, Ug=0,6 ë.m-2K-1, izolimi akustik Rë-34 dB.				
1.9.10	Pos D2 me dimensione 240*240 cm	copë	1.00	650.00 €	650.00



	Furnizimi dhe montimi i dyerve te klasave dhe sallave nga druri i kualitetit të lartë me të gjitha elementet përcjellëse				
1.9.11	Pos D3 me dimensione 100*210 cm	copë	11.00	220.00 €	2,420.00
1.9.12	Pos D4 me dimensione 90*210 cm	copë	8.00	190.00 €	1,520.00
	Furnizimi dhe montimi i derës te hyrja e parashkolloreve prej profileve te aluminit profil t=8.0cm me xham të trefisht 4+16+4+16+4 mm, Uë=0,8 ë.m-2K-1 mbushje me argon, Ug=0,6 ë.m-2K-1, Izolimi akustik Rë-34 dB.				
1.9.13	Pos D5 me dimensione 220*220 cm	copë	1.00	750.00 €	750.00
	Furnizimi dhe montimi i dyerve te Nyjeve Sanitare nga PVC profilet. Profili me diameter te baze Min. 8cm , me min. 5 komora (hapesira termike) dhe tre mbyllje gome. Plastika te jet e lidhur me profil te çelikut adekuat per profilin e caktuar. Profili duhet te arrihet vlerat Uf prej 1.3 W/m2 . Panell thermopan dizajni i te ciles duhet te jet i afert me projektin zbatues. Dyert duhet te ankorohen me bulona te galvanizuar .				
1.9.14	Pos D6 me dimensione 100x210 cm	copë	1.00	160.00 €	160.00
1.9.15	Pos D8 me dimenstone 70x210 cm	copë	2.00	140.00 €	280.00
1.9.16	Pos D7 me dimensione 80x210 cm	copë	23.00	150.00 €	3,450.00
	Furnizimi me material dhe montimi i deres nga metall per qasjen ne hyrjen ekonomike-kaldatores me dimensione				
1.9.17	Pos D10 me dimensione 140*230 cm	copë	1.00	140.00 €	140.00
	Furnizimi me material dhe montimi i deres nga metall per qasjen ne shkallet emergjente me dimensione				
1.9.18	Pos A6 me dimenstone 180*240 cm	copë	2.00	240.00 €	480.00
TOTALI POSICIONI:					31,095.00
1.10. PUNËT E GLETTIT DHE FASADËS					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësla	Sasla	Çmimi	Totali
1.10.1	Gletimi i te gjitha mureve të brendshme dhe pllafoneve ne dy shtresa (ketu nuk parashihen muret te nyjet sanitare), paraprakishte të behet pergaditja me lenden baze, siperfaqja duhet te jete e lemuar dhe gatshme per ngjyrosje	m ²	4950.00	1.70 €	8,415.00
1.10.2	Furnizimi dhe ekzekutimi i fasadës termike demit (ne llogari te merret stiropori 8cm, rrjetë rabric,llaq i plastifikuar dhe ngjyra) në niansë sipas përzgjedhjes së projektuesit ose investitorit.	m ²	20.00	120.00 €	2,400.00
1.10.3	Furnizimi dhe ekzekutimi i fasadës termike demit edhe pjesa tjetere e fasades (pa stiropor dhe rrjetë te atika dhe elementet tjera te jashtme) në nuansë sipas përzgjedhjes së projektuesit ose investitorit.	m ²	220.00	10.00 €	2,200.00
TOTALI POSICIONI:					13,015.00



1.11. PUNËT E NGJYROSJES					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.11.1	Ngjyrosja e mureve, pllafoneve të kthlnave mbi bazament të gjetuar me polikolor ne dy shtresa me nansë të bardhë.	m ²	4950.00	0.50 €	2,475.00
1.11.2	Furnizimi dhe lyerja e mureve te kthlnave dhe koridoreve me ngjyre te yndyrshme ne lartesi h = 1.0 m'	m ²	520.00	2.00 €	1,040.00
TOTALI POSICIONI:					3,515.00
1.12. PUNËT E QERAMIKËS DHE GRANITIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.12.1	Furnizimi dhe mveshja e dyshemesë se erembrojtetit, hollit, koridoret dhe recepsionit me pllaka te granitit artificial ne llaq të cementos, dizajni sipas investitorit ne llogari te merret edhe punimi i perimetrit h=10.0 cm	m ²	450.00	14.00 €	6,300.00
1.12.2	Furnizimi me material dhe mveshja e mureve (sanitaret) me pllaka të keramikës te kualitetit te lartë. Dizajni sipas investitorit	m ²	640.00	13.00 €	8,320.00
1.12.3	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshmeve (sanitaret) me pllaka të keramikës te kualitetit te lartë. Dizajni sipas investitorit	m ²	112.00	13.00 €	1,456.00
1.12.4	Furnizimi dhe mveshja e dyshemesë me pllaka të keramikës (dyshemeja ne hapsiren e kaldatores)me llaq të çimentos. Ne llogari te merret edhe punimi i perimetrit h=10.0 cm	m ²	40.00	12.00 €	480.00
1.12.5	Furnizimi, mveshja e shkalleve, rampes dhe pjeseve hyrese me pllaka të granitit. Dizajni sipas investitorit	m ²	105.00	35.00 €	3,675.00
1.12.6	Furnizimi i materialit dhe punimi i cokles me kulr, dizajni sipas projekuesit ose investitorit	m ²	220.00	4.00 €	880.00
1.12.7	Furnizimi dhe vendosja e dyshemesë se linoeumit (ne rolne) lldhja behert me ngjites adekuat, ne llogari te merret shtresa vetenivilizuese, ngjites adekuat, diktuni dhe shiriti rreth perimetrit te mureve ne lartesi h=8 cm	m ²	880.00	8.00 €	7,040.00
TOTALI POSICIONI:					28,151.00
1.13. PUNËT E PLLATOSË					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.13.1	Gërmimi i humusit në thellësi prej 30 cm, gërmimi duhet te behet ne tere siperfaqen e platos, si dhe transporti i dheut deri ne deponi.	m ³	260.00	1.50 €	390.00
1.13.2	Rrafshimi dhe nivelizimi i nënbazës së sipërfaqes së parterit me saktësi deri në ±2 cm, duke krijuar pjerrtesin e nevojshme terthore per kullimin e ujrave siperfaqesore, ngjeshja me cilindër vibrues deri ne arrijten e kompaktesis prej Ms= 30 Mpa.	m ²	660.00	0.20 €	132.00
1.13.3	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e materialit nga guri i thyer me frakison 0-63 mm me trashesi t=20 cm ne gjendje te ngjeshur (Ms=40 Mpa) .	m ³	160.00	8.00 €	1,280.00
